



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MBROJTJES CIVILE

Nr. 447/17 Prot.

Elbasan, më 18. 4.2023

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj.

BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit tuaj **Nr.28 datë 31.03.2023** "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (rrëshqitja e tokës) të banesës së **Znj. Albina Bashkim KURTI**, banore në fshatin Funarës, Njësia Administrative Orenjë", para se të shprehemi mbi ligjshmërinë e aktit tuaj kërkojmë të na dërgoni dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të parashikuar në **V.K.M Nr 329 datë 16.05.2012** "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Nga shqyrtimi i dosjes mungojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Studimi Gjeologjik
2. Leja e Ndërtimit

Deri në dërgimin e dokumentacionit, akti i juaj mbetet i pakonfirmuar.



PREFEKTI

Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Dt.03.04.2023

Nr. 1534 prot

Nr.28 dt.31.03.2023

PER MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO LIGJOR DHE PER AKORDIMIN E
NDIHMES FINANCIARE PER FAMILJET QE KANE PESUAR DEME NE BANESAT E
TYRE NGA FATKEQESI NATYRORE

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ „ Ligjit Nr.45/2019 date 18.07.2019“Për Mbrojtjen Civile “, VKM-SE Nr.329 date 16.05.2012“Për kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes financiare,per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore“ „Kreu 111/3/e si dhe VKM-se Nr.414 date 08.07.2021 “Per miratimin e procedurave dhe kriteret e ndarjes dhe te perdorimit te fondit te kushtezuar ,te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile.” Pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori I Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar .”Per dhënie te ndihmës financiare ,per demet e shkaketuara nga fatkeqesi natyrore (rreshqitje siperfaqesore toke) ne banesen e Znj.Albina KURTI banore e fshatit Funarës,NJ./A.Orenje Bashkia Librazhd.Këshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 31.03.2023 dhe me propozim te Kryetarit te Bashkise Librazhd:

VENDOSI:

- 1.Të miratoj kërkesën e Bashkisë Librazhd,per mbeshtetje financiare per shtetasen Albina KURTI banore I fshatit Funarës,NJ/.Orenje,për shkak se banesa e saj është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore(rrëshqitje toke)
- 2.Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur nga specialistet e Bashkise Librazhd dhe vleren financiare të demit në shumën: 1 521743 lekë si dhe ndihmën emergjente në vlerën financiare 760 871 leke e llogaritur ne 50% te vlerës së demit për banesën e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (rrëshqitje toke) të shtetases Albina KURTI.
- 3.Ndihma financiare per familjen e Znj.Albina KURTI banesa e te ciles eshte demtuar nga fatkeqesi natyrore percaktohet sipas kriterëve te VKM-se Nr.329 date 16.05.2012 .
- 4.Ndihma financiare qe do te akordohet do te perdoret per ti ardhur ne ndihme familjes se Znj.Albina KURTI banesa e te ciles është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (rreshqitje toke)
- 6.Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sek.i Keshillit
Elson Malluta

KRYETARI I KESHILLIT
Shefki Bahiti

